


2635/6
3+3+3
12-07-2023



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arhiva - Arhiva - Archive

Hëna, Ora: 06/401 Nr. Prot. 1387-1/2023
Ditë: 10.07.2023

Nr. i Kosovës: 7/ Dërguesi: PHANTHICIA

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Ministarstvo za Finansije, Rada i Transfera, Ministry of Finance, Labour and Transfers
Departamenti i Buxhetit - Odeljenje Budžeta- Budget Department

DATË/A:	10.07.2023
REFERENCË	NV - 117/2023
PËR/ZA/TO:	Z. Isah Rudaku, Zv. Drejtor, Departamenti Ligjor, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
NGA/OD/FROM:	Z. Salvador Elmazi, Drejtor i Departamentit të Buxhetit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinionimi i Departamentit të Buxhetit për vlerësimin e ndikimit buxhetor për Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Deutsche Gesellschaft Fur Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, për projektin Mbështetja për Zhvillimin e Qëndrueshmërisë të Sektorit të Bujqësisë në zonat rurale përmes diversifikimit të aktiviteteve

I nderuari z. Rudaku,

Bazuar në kërkesën për Vlerësimin e Ndikimit Buxhetor për Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Deutsche Gesellschaft Fur Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, për projektin Mbështetja për Zhvillimin e Qëndrueshmërisë të Sektorit të Bujqësisë në zonat rurale përmes diversifikimit të aktiviteteve, të përgatitur nga propozuesi - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR), obligimin sipas nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe nenin 18 të Ligjit Nr. 08/L-193 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023,

Departamenti i Buxhetit të Kosovës, paraqet me sa vijon:

I. ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PROJEKTLIGJIT

Qëllimi i këtij projektligji është ratifikimi i Marrëveshjes në mes të Republikës së Kosovës, të përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Deutsche Gesellschaft Fur Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, për projektin Mbështetja për Zhvillimin e Qëndrueshmërisë të Sektorit të Bujqësisë në zonat rurale përmes diversifikimit të aktiviteteve.

II. OPINIONI PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT BUXHETOR (VNB) NGA ORGANI PROPOZUES

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural si organ propozues e ka përgatitur vlerësimin e ndikimit buxhetor të projektligjit dhe e ka paraqitur përmes formularit të vlerësimit të ndikimit buxhetor, sipas të cilit vlerësohet se ky projektligj ka një kosto totale në shumë prej 20,250,000 euro për periudhën 2024-2026 e cila është e shpërndarë sipas burimeve të financimit dhe kategorive të shpenzimeve si vijon:

Vitet	2024	2025	2026	Total
Donatorët:	2,500,000	5,225,000	2,500,000	10,225,000
- GIZ				
Buxheti i Kosovës	5,000,000	5,000,000	0	10,000,000
Subvencione dhe Transfere	5,000,000	5,000,000	0	10,000,000
Gjithsej	7,500,000	10,250,000	2,500,000	20,225,000

Siç shihet nga tabela e mësipërme, Qeveria e Republikës së Kosovës - MBPZHR, obligohet që për periudhën kohore 2024-2026 të ndajë shumën buxhetore prej 10,000,000 euro, për të cilën shumë, MBPZHR është deklaruar se do të ndajë nga ndarjet buxhetore të parapara me Ligjin Nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 dhe vlerësimet për vitet 2024-2025. Ndërsa pjesa tjetër në shumë prej 10,225,000 euro do të mbulohet nga donatori – GIZ.

Aktivitetet kryesore që rrjedhin nga ky projektligj janë:

- Ofrimi i asistencës teknike për diversifikimin e aktiviteteve në zonat rurale i cili përfshinë: përcaktimin e fokusit të projektit, fushëveprimin dhe partnerët, kryerjen e të gjitha aktiviteteve që kanë të bëjnë me dorëzimin e propozimeve duke u mbështetur në programin, mobilizimin e burimeve nder sektoriale, sigurimin e monitorimit dhe vlerësimit të qëndrueshëm të projekteve të përbashkëta, etj;
- Grantet e investimeve për bizneset fillestare rurale deri në vlerë prej 5,000 euro (me fokus në gratë, të rinjtë dhe grupet e marginalizuara) dhe nga 5,000-350,000 euro për NMV-të rurale duke përfshirë investimet për grupet e fermerëve.

III. PËRFUNDIM

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti i Buxhetit vlerëson se Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Deutsche Gesellschaft Fur Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, për projektin Mbështetja për Zhvillimin e Qëndrueshmërisë të Sektorit të Bujqësisë në zonat rurale përmes diversifikimit të aktiviteteve, nuk krijon kosto shtesë buxhetore për vitet 2024 -2026 dhe se zbatimi i të gjitha aktiviteteve që rrjedhin nga ky projektligj - obligimet e MBPZHR, do të mbulohen nga ndarjet e rregullta buxhetore të parapara me Ligjin Nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së

Kosovës për vitin 2023 dhe vlerësimet për vitet 2024-2025 për MBPZhR dhe nga donatori GIZ.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve nuk merr për obligim që nga Buxheti i Republikës së Kosovës të financoj aktivitetet të cilat janë të parapara të financohen nga donatorët.

Përgatitur nga: Albulena Blaku, Analiste e Lartë e Buxhetit

